



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5241/Prot  
1

Tiranë, më 20/12/2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

**DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN**

**KËTU**

**DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT  
DHE AFTËSIVE TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës” dhe shkresës me nr.7864 prot, date 09.12.2022 “Njoftim për vend të lirë pune në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Tiranë, protokolluar në AKPA me nr.5241 prot, datë 09.12.2022, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-s, brenda datës 20.12.2022, si më poshtë:

**Pozicioni i punës:**

Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, Zona 1, për zëvendësim leje barrë lindje, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë.

**1. Kritere të përgjithshme:**

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

**2. Kritere të posaçme:**

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare “Bachelor”.
- b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit.
- c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

### 3. Dokumentet e aplikimit:

- a. letërmotivimi për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”;
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën dhe listën e notave;
- e. librezën e punës (nëse ka eksperiencë pune);
- f. çdo dokumentacion tjetër, që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
- g. certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetim nga punëdhënësi i fundit,që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse ka eksperiencë pune);
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm (nëse ka eksperiencë punë).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe të jenë të noterizuara.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-s, brenda datës 28.12.2022.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë zhvillohet si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë në:

- i. arsimimi: 20 pikë;
- ii. njohuritë në fushën e TIK- ut: 20 pikë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;
- Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët.

- Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:

- Ligji nr.15/2019 "Per nxitjen e punesimit";
  - Ligji nr.45/2016 "Per Vullnetarizmin";
  - VKM nr.17, date 15.01.2020 "Per procedurat, kriteret dhe rregullat per zbatimin e programeve te nxitjes se punesimit nepernjet punesimit, formimit ne pune dhe praktikave profesionale"; i ndryshuar;
  - VKM nr.348, date 29.04.2020 "Per procedurat, kriteret dhe rregullat per zbatimin e programeve te nxitjes nepernjet vetepunesimit";
  - VKM nr.535, date 08.07.2020 "Per procedurat, kriteret dhe rregullat per zbatimin e Programit te Puneve Publike ne Komunitet";
  - VKM nr.608, date 29.07.2020 "Per procedurat, kriteret dhe rregullat per zbatimin e programeve te nxitjes se punesimit te personave te dale te papune si pasoje e Covid-19"; i ndryshuar;
  - VKM nr.554, date 31.07.2019 "Per krijimin, menyren e organizimit dhe te funksionimit te Agjencise Kornbetare te Punesimit dhe Aftesive", i ndryshuar
  - VKM nr.161, date 21.03.2018 "Per pagesen e se ardhures nga papunesia".
  - VKM nr.837, date 28.10.2020 "Per procedurat, kriteret dhe rregullat per ofrimin e sherbirneve te punesimit" i ndryshuar;
- ii. motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
- Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve.
  - Minimumi i pikëve për t'u kualifikuar është 70 pikë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Klevis HYSA**